



DITARI KULTURORE

Drejtoria e Promovimit

Nr. 6

30 maj 2008

NGJARJET E JAVËS

KULTURË

KONCERTE/BALET

Muzika dhe Poezia

Koncert Gala

Aperitiv

Musical "Trafik në Tarracën 47"

ARTET PAMORE

Urë - Ndërtues - Ekspozitë

Abaz Hado - Ekspozitë

Retrospektivë - Ekspozitë

Enigmë e pezullt - Ekspozitë

TEATËR

Grogrè

KINEMA

What Happens in Vegas

TURIZËM

Panairi i Turizmit Shqiptar


Drumball 2008 në Tiranë

EKONOMI

Fiera del Levante - Panair

"ZJARR ANADOLLI"

- për të "djegur" Tiranën-



Kompania e dancit "ZJARRI I ANADOLLIT", ekonsideruar si një nga grupet më të mirë të kërcimit folk në botë, fitues i rekordeve Gines, do të jetë në Tiranë më 1 qershor, Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, dhe do të japë një koncert madhështor në Pallatin e Kongreseve.

më shumë....

NGJARJET E PRITSHME

30 maj - 3 qeshor 2008

KULTURË

KONCERTE/BALET

Thuaj Po - 1 qershor
dita ndërkombëtare e fëmijëve

ARTET PAMORE

Peisazhe, kompozime, portrete
Piktura origjinale
Peisazhe, kompozime,
natyrë e qetë

TEATËR

Veza Magjike
Kësulëkuaja
Festa e 1 Qeshorit

KINEMA

Ndalove Humbe

Adresa: Rr "Ded Gjo Luli", Tiranë
E-mail: infotourism@tirana.gov.al
Web Site: www.tirana.gov.al

KONCERTE/BALET

Muzika dhe Poezia



Koncerti "Muzika dhe Poezia" me vepra të kompozuar për vokal dhe instrumenta shoqërues u organizua nga Shoqata "Muzika e Re Shqiptare", më 26 maj në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Balett. Ky koncert erdhi si

pjesë e festivalit "Ditët e Muzikës së Re Shqiptare" ku u interpretuan vepra të literaturës botërore. Synimi i këtij koncerti ishte pasurimi i trashgimisë së muzikës shqiptare për vokal dhe piano.

Koncert Gala

Universiteti UFO organizoi më 25 maj, një Koncert Gala në Pallatin e Kongreseve ku performuan emrat më të njohur të kantos e balettit jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë kufijve.



U dëgjuan tingujt e Orkestrës së Harqeve të TVSH-së në drejtimin e Oleg Arapit.

Në koncert kënduan tenori Kastriot Tusha, mexosoprano Vikena Kamenica dhe soprano Ramona Tullumani. Ishin të ftuar edhe balerinë të mirënjohur rus të "Balshoi Teatër"

Aperitif - muzikë

Aperitif janë mbrëmjet e së mërkurës, që organizohen çdo muaj nga "Miqët e Galerisë" dhe shoqata "Miqët e muzikës" në Galerinë Kombëtare të Arteve për të festuar me komunitetin artistik dhe për kënaqësinë e të gjithë dashamirësve të artit dhe miqve të tyre.



Në "Aperitiv" të datës 21 Maj u luajt muzikë nga Ethem Qerimaj, organizuar nga Pjetër Guralumi. Muzika u luajt në funksion të një ekspozite me vizatime të Bujar Zajmit me portrete të shumta nga jeta shqiptare.

Video – Projektion Trilogjia e udhëtimit

Në kuadrin e pasqyimit të veprimtarisë së Aleksandër Peçit, më 24 maj, në hollin e TKOB u shfaqën me një video – projektor pjesë nga "Oirat", opera "Etera Tondo" dhe "Oratorio Spaciale" sipas "Prajsës" të "Komedisë Hyjnore" të Dante Aligerit.

Zhani Ciko, Hamide Stringa e Nestor Kraja shpjeguan veprat e sipërpërmendura duke shpalosur një trajtim analitiko-teorik të tyre. Në pjesën e dytë u bë promovimi i CD-së "The Broken Song" prodhuar në Nju Jork nga Labor Records.



Klitheu Tragjik

Klitheu tragjik, vepër e kompozitorit Aleksandër Peçi për orkestër harqesh u luajt më 23 maj Akademinë e Arteve në Tiranë si një bashkëpunim midis Aelfior dhe Radio Televizionit Shqiptar.



Orkestra e RTSH-së nën drejtimin e mjeshtrit Malcolm Layfield nga Manchesteri luajti për herë të parë 8 vepra të Peçit.

Trafik në Tarracën 47 Musical

Qendra "Sirea Film" e familjarizuar tashmë me skenën dhe ekranin i dhuroi publikut tiranas muzikalin origjinal "Trafik në Tarracën 47", i cili javën e kaluar u shfaq për 4 ditë me radhë në Akademinë e Arteve.

Ky muzikal bashkoi artistët Jorgo Papingji, Albi Nako, Leonard Bombaj, Llaqi Nako dhe Klodian Qafoku së bashku me 80 të rinj të talentuar. Publiku e ndoqi ngjarjen si një film që luhet në skenë. Të rinjtë gjetën të pasqyruar në këtë muzikal dëshirat dhe dilemat e tyre në realitetin shqiptar.

Koncert

Më 23 maj në sallën "Çesk Zadeja" u dha një koncert me studentë të Akademisë së Arteve, ku u

interpretuan pjesë nga operat më të rëndësishme të vëna në skenat shqiptare:

"Dasma e Figaros" nën interpretimin e sopranos Blerta Zani; koncert për piano, pjesë nga Giovanni Botesini interpretuar në piano nga Mirela Koka; pjesë nga opera "Flauti Magjik" dhe "Romeo e Zhulieta" interpretuar nga studentët Marjeta Billo e Marisa Trako.

Koncert i artistëve të Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit dhe të Ansambilit Popullor

Në kuadër të takimit të 19-të Klubit të Guvernatorëve të Bankave Qëndrore të Azisë Qëndrore, Rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit, Banka e Shqipërisë organizoi në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit më 23 maj një koncert për dashamirësit dhe miqtë e te dyja zhanreve. Interpretuan orkestra, kori, solistët dhe trupa e valleve.


Koncert Festiv me Këngë dhe Valle Popullore Tiranase

Qendra Kulturore "Tirana" organizoi në Arenën e Cirkut Tiranë më 23 maj një koncert festiv me këngë valle popullore tiranase me pjesëmarrjen e këngëtarëve, valltarëve dhe orkestrantëve të Ansambilit "Tirana".

ARTE PAMORE**Urë - Ndërtues**

Roland Tasho. Pikërisht këtë temë trajtojnë të 45 fotot e tij të paraqitura në këtë ekspozitë .

Kjo ekspozitë është vazhdim i projektit, të cilin artisti e ka filluar që në vitin 2003, me shqiptarët e Italisë "L'altra Albania" dhe do ta vazhdojë edhe pas prezantimit të kësaj ekspozite edhe me shqiptarët e Greqisë.

Abaz Hado

Forcave të Armatosura. Në këto punime janë trajtuar pamje të Tiranës në ditë me borë dhe shi si dhe fshehtësia romantike e hijeve dhe dritave të rrugicave karakteristike të qyteteve të lashtë si Berati.

Ambasada Zviceriane në Shqipëri, prezantoi më 23 maj në sallën Nr. 2 të Galerisë Kombëtare të Arteve, ekspozitën fotografike "Urë - Ndërtues" të artistit

Enigmë e Pezullit Ekspozitë


Po prezantohet deri më 31 maj ekspozita personale e Naxhi Bakallit, në Sallën Nr.1 të Galerisë Kombëtare të Arteve (salla e madhe).

Më shumë se 60 vepra të punuara kryesisht në akrilik, të përmasave të ndryshme, në telajo pasqyrojnë misterin e ngjizjes së jetës në ekspozitë. Ngjyra është e pastër dhe e interpretuar konceptualisht.

**Fjalor Jeshil Ekspozitë nga Ardian Isufi**

"Fjalori Jeshil" dhe "Shenja Humane", të cilat konsistojnë në hulumtimet artistike të mardhënies ndërmjet trupit të njeriut (individit) dhe realitetit absurd që e rrethon, vijnë në Ambasadën Gjermane nga data 19 maj – 12 qershor, (nga e hëna deri të enjten nga ora 15:00 deri në orën 17:00).

Përpjekjet dhe mundimet e njeriut për të dokumentuar dhe dhe tjetërsuar atmosferën e pasigurt dhe të paqëndrueshme që ndodhet janë fiksuar në teknika të përziera mbi kanavacë, asemblazhe dhe instalime, të cilat pasqyrojnë qartë shtjellimet artistike në situata dy dhe tre dimensionale.



Homazh për Mbretëreshën Susan



Piktorja Natasha Bega erdhi deri më 23 maj në Galerinë Kombëtare të Arteve me një ekspozitë personale e gjitha në homazh të Mbretëreshës Susan.

Bien në sy tabllotë, në të cilat është derdhur gjithë

fantazia, ndjeshmëria, feminiliteti dhe respekti për këtë figurë të nderuar femërore.

Pikturë

Artistja e re Albana Rexha prezanton punimet e veta në një ekspozitë personale në ambientet e galerisë "Ibrahim Kodra" në Ministrisa e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) nga data 21 maj.

Ajo paraqitet me rreth 30 punë në pikturë. Punët e ekspozuara u përkasin viteve të fundit dhe vijnë në teknikën e vajit.

Njeriu

Rreth 30 piktura, teknika kryesisht vaj mbi kanavacë, akrilik, por edhe në teknika mix e karbon, janë ekspozuar në një ekspozitë të artistit Stefan Taçi. Punime të përmasave të ndryshme me një gamë të gjerë koloriti mirpresin vizitorët në galeri "Kledjo". Tregimi nga një

Ekspozita - Tregime nga një botë në globalizim

"Tregime nga një botë në globalizim"- ekspozitë ndërkombëtare fotografike me



200 punime të dhjetë autorëve nga vend të ndryshme të botës, është zhvendosur nga Kabuli për në Tiranë.

Kjo ekspozitë është vendosur në një kënd të parkut "Rinia", ku është e vizitueshme në çdo orë të ditës dhe do të qëndrojë aty deri më 2 qeshor.

TEATËR

Grogrè

Istituti Italian i Kultures në bashkëpunim me Teatrin Kombëtar të Tiranës, paraqiti më 22 maj, shfaqjen teatrale Grogrè, të interpretuar nga Marco Zannoni, nën drejtimin e Angelo Savellit të shoqërisë "Pupi e Fresedde - Teatro di Rifredi". I frymëzuar nga libri "Sorelle Materassi" të shkrimtarit Aldo Palazzeschi, Grogrè paraqet një copëz të jetës së Firences në fillim të shekullit nëpërmjet dialektit Toskan të fortë plot humor popullor.

KINEMA

What Happens in Vegas Komedi, romancë

"What Happens in Vegas" shfaqet në Millennium në Tiranë. Tom Vaughan (regjisor) e Dana Fox (skenariste) arrijnë të shndërrojnë një histori normale në një film të bukur, me humor dhe aspak të mërzitshëm. Përzierja e elementëve si aktorët, regjia dhe skenari - të gjitha të realizuara - krijojnë një histori që zbavit dhe për aq sa mundet të fton të reflektosh.



TURIZËM

Panairi i Turizmit Shqiptar

U organizua dje me datë 29 maj Panairi Shqiptar i Turizmit pranë ambienteve të qendrës tregtare "Casa Italia". Në këtë panair morën pjesë të gjithë sektorët privat dhe publik që operojnë në fushën e turizmit kombëtar dhe ndërkombëtar si agjenci turistike, kompani ajrore, hotele, etj.

Drumball 2008 në Tiranë

100 të rinj nga Anglia me 35-së makinat e tyre të ngjyrosura në format nga më të ndryshme të mundëshme, udhëtojnë me makinat e tyre nga Brukseli në Korfuz.

Ata kanë një veçori, sepse nuk janë të famshëm dhe aspak të pasur, por kanë një shpirt të madh përfaqësimi dhe entuziazmin e rinisë. Ata janë bashkuar për të xhiruar me makinat e tyre nëpër të gjithë Europën dhe dje vizituan edhe kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranën (29 maj)

Të rinjtë kërkojnë të mbledhin fonde për fëmijët që kanë humbur prindërit

në luftërat e ish-Jugosllavisë dhe ky është edhe qëllimi sensibilizues i tyre. "The Dumball Rally" turin nëpër Europë e kanë filluar që nga data 24 maj nga Brukseli dhe do të mbërrijnë me datë 31 maj në Korfuz.



1 QERSHORI - DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE

Thuaj Po

Këtë vit motoja e aktivitetit do të jetë "Thuaj po për fëmijët", thuaj Po për ëndrrat dhe dëshirat e tyre të përealizuara, thuaj Po zbatimit të të drejtave të fëmijëve. Kjo ditë do të kthehet në një apel drejtuar politikanëve dhe vendimmarrësve të të gjitha niveleve për të kthyer akoma më shumë vëmendjen ndaj fëmijëve dhe problemeve të tyre. Kjo do të realizohet përmes këngës, argëtimit dhe shpalosjes së dëshirave e kërkesave të fëmijëve. Aktiviteti do të realizohet në Sheshin Skënderbej dhe do të përfshijë një koncert artistik me këngë e kërcime, konkursin e balonave dhe animacionet me tullumbace dhe lojra interaktive.

10:00 – 12:00

Sheshi para Skënderbeut
"Dëshira ime më e madhe"-
Balona më e bukur
"Unë kam të drejtë për ..."



10:00 – 11:30

Sheshi para Muzeut Kombëtar
"Dua të dëfrem me ju" - Koncert artistik për fëmijët

10:00 – 11:00

Muzeu Kombëtar
"Luajmë së bashku" – Lojra dhe argëtim për fëmijët e çerdheve të Tiranës



11:00 – 12:00

Qendra e Bashkisë së Tiranës për fëmijët dhe familjen
"Të festojmë së bashku" - Koncert dhe shpërndarje e dhuratave për fëmijët në nevojë

12:00 – 13:30

Sheshi para Muzeut Kombëtar
"I lindur për të lexuar"- Lexime dhe shpërndarje e librave për fëmijë
Shpërndarja e librit "Qyteti që unë dua"



17:00 – 18:30

Qendra Kulturore Tirana
Shfaqje e Cirkut të Tiranës,
akrobaci, balet modern.



ARTE PAMORE

Kompozime

Të përmbledhura në një botim luksoz, piktori Artur Muharremiku u paraqitet artdashësve dhe kritikës me rreth 80 punime, teknikën vaj, në akrilik dhe teknikë e përzier.

Veprat janë rezultat i përjetimit të një gjejdjeje emocionale në një moment të caktuar dhe i ngritjes së saj në telajo.



Peisazhe, kompozime, portrete

Vazhdojnë të ekspozohen edhe këtë javë punimet e Zaim Elezit, në Art Studio "ZAYA" ku ndjehen motivet nga fshati duke i kushtuar vëmendje rriteve e traditës nëpërmjet stilit të tij artistik.

Piktura origjinale

Punime nga Onorina Jata - piktura origjinale me përmasa, forma dhe ngjyra të ndryshme, të këndshme për hapësirat, ambientet dhe njerëzit më të dashur – mund t'i vizitoni në galerinë "Tegabuna".



Peisazhe, kompozime, natyrë e qetë

Piktorët Kokonozi, Çene dhe Tasi sjellin punimet e tyre në një ekspozite të përbashkët tek Salloni "DidArt". Ekspozita është konceptuar si një e vetme pavarësisht trajtimit individual që i bën sejcili punëve të veta.



TEATËR

Veza Magjike

Për fëmijët Teatri i Kukullave më 30 maj, ora 18:00 do të shfaqë premierë "Veza Magjike" me autor Agim Doçin dhe regji nga Klaudia Hila. "Veza magjike" trajton temën "Jo ushqime OMGJ".

Kësulëkuqja

Më datë 31 maj, ora 11:00 Teatri i Kukullave do të shfaqë pjesën teatrale "Kësulëkuqja".

Festa e 1 Qeshorit

Të gjithë fëmijët e kopshteve të Tiranës do të marrin pjesë në festimet që do të organizohen në Teatrin e Kukullave me rastin e 1 Qeshorit- Ditës së Fëmijëve.

KINEMA


"Sweeney Todd: - The Demon Barber of Fleet Street"

Një nga 10 filmat më të mirë të vitit, shfaqet premierë të mërkurën në Millennium 2. Johnny Depp, një berber diabolik në kinema!

Nga regjisori i "Batman" dhe skenaristi i "Gladiator" vjen përshtatja e muzikalit të famshëm të Broduejit. Filmi më i mirë për gjininë e komedisë apo muzikalit dhe aktori më i mirë i kësaj gjinie në Golden Globe. Oskar për skenografinë më të mirë.

"Sweeney Todd: The Demon Barber of Fleet Street" është një muzikal triller dhe një përshtatje kinematografike e muzikalit me të njëjtin titull të Stephen Sondheim e Hugh Wheeler. Filmi është një përpjekje e guximshme e regjisorit Tim Burton (të njohur me filmin "Batman") për të mishëruar në kinema një nga muzikalet më të famshme të Broduejit duke treguar se edhe në film historia e berberit demon në rrugën Flit mund të qëndrojë fare mirë.

Ndalove Humbe



Kinema "Imperial" ofron dy seanca të filmit "Stop Loss" në mbrëmje, kryesisht në oraret 21:00 dhe 23:00.

"Dëshira për të jetuar rininë, bukurinë e jetës", është mesazhi që përcjell ky film nëpërmjet lojës së bukur të aktorëve.

Zjarr Anadulli për të "djegur" Tiranën

Kompania e dancit "Zjarri i Anadollit", e konsideruar si një nga grupet më të mirë të kërcimit folk në botë, fitues i rekordeve Gines, do të jetë në Tiranë më 1 qershor, Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, dhe do të japë një koncert madhështor në Pallatin e Kongreseve.

Është një nga ngjarjet më të mëdha kulturore për Shqipërinë, duke patur parasysh jo vetëm famën që ka kjo kompani danci, por edhe bashkëpunimin kulturor që ka ekzistuar mes dy popujve në vite. Ky grup është ndjekur nga miliona artdashës në shumë vende të ndryshme të botës.

Repertori i tyre përfshin një sintezë të figurave popullore që burojnë nga historia kulturore dhe mitologjike e Anadollit. "Zjarri i Anadollit", përmes lëvizjeve dinamike dhe tërësisht profesionale, përcjell kulturën e pasur të Anadollit dhe magjinë e kërcimit në një stil të madhërishtë.